




REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dip. Dep.	DPKI
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	06-514/20
Data Datum Date	28.02.2020
Nr. ffaq Str. / Stranca Nr. pages	03



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 28.02.2020, mori:

**V E N D I M**

- I. Mbyllet rasti me Nr.AKK-DPKI-06-01/1572/19, për z. Eset Berisha, Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin për ekzistimin e konfliktit të interesit lidhur me kufizimin pas përfundimit të ushtrimit të funksionit publik.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

**A r s y e t i m**

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt të interesit në ushtrimin e funksionit publik, për z. Eset Berisha, Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr.06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në tekstin e mëtutjeshëm: LPKI).

Në këtë rast, z. Eset Berisha, është hetuar për mundësinë e ekzistimit të konfliktit të interesit, meqenëse ai paraprakisht ka ushtruar funksionin publik si Këshilltar Politik i Ministrit të Infrastrukturës dhe Transportit, deri me datë 11.01.2019, për t'u emëruar pastaj në postin e Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës.

Agjencia kundër Korrupsionit në bazë të dokumentacionit në dispozicion, pasi e ka shqyrtuar dhe analizuar të njëjtin dhe duke vepruar sipas procedurave të parapara me LPKI, e ka njoftuar zyrtarin me një shkresë zyrtare për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit.

Pas pranimit të kësaj shkrese nga z. Eset Berisha, me kërkesën e tij në kuptim të nenit 22 të Ligjit LPKI, është organizuar takim me të njëjtin në Agjencinë kundër Korrupsionit. Gjatë këtij takimi Zyrtari i lartë, ka deklaruar se ka ushtruar funksionin publik në pozitën e Këshilltarit Politik të Ministrit të Infrastrukturës dhe Transportit, në periudhën 01.11.2017 deri me 11.12.2019.



z. Eset Berisha, gjithashtu ka deklaruar se emërimi i tij në pozitën Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, është bërë sipas dispozitave të Ligjit NR. 03/L-051, për Aviacionin Civil, ku në nenin 20.3 përcaktohet se *“Ministri bën përpjekje të arsyeshme për identifikimin e personave të cilët i posedojnë kualifikimet e përcaktuara më sipër dhe të cilët janë të interesuar që të emërohen në postin e Drejtorit të Përgjithshëm. Ministri i siguron Qeverisë (i) emrin dhe CV-n për secilin kandidat të cilët posedojnë kualifikimet e kërkuara, dhe (ii) rekomandimin e tij lidhur me secilin kandidat të këtyllë. Qeveria, pas pranimit të sipërpërmendur nga Ministri, bën emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm”*.

Pra, duke u bazuar në këtë dispozitë z. Eset Berisha, ka deklaruar se Ministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, ka propozuar tre kandidatë për Qeverinë e Kosovës, me ç ‘rast në mbledhjen e 83-të, të Qeverisë së Republikës së Kosovës të mbajtur me datë 11.01.2019, ai është emëruar në postin e Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës me mandat pesë vjeçar.

Gjithashtu z. Eset Berisha, ka deklaruar se Autoriteti i Aviacionit Civil është institucion i pavarur që i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe se emërimi i tij në këtë pozitë nuk cenon dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Agjencia kundër Korrupsionit ka analizuar dispozitat e Ligjit për Aviacionin Civil, ku në Nenin 14 pika 1 përcaktohet *“Autoriteti i Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës (AAC) themelohet me këtë ligj, si Agjenci e Pavarur Rregullatore. AAC është përgjegjëse për rregullimin e sigurisë së aviacionit civil dhe rregullimin ekonomik të aeroporteve dhe shërbimeve të navigimit ajror në Republikën e Kosovës. AAC ka kapacitet të plotë juridik. AAC është organizatë buxhetore dhe autoritet publik dhe i nënshtrohet dispozitave përkatëse mbi organizatat buxhetore dhe autoritetet publike në ligjet dhe aktet e tjera ligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës”*.

Gjithashtu bazuar në këtë Ligj në nenin 26 parashihet llogaridhënia dhe përgjegjësia e Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, ku përcaktohet se *“Drejtori i Përgjithshëm përgjigjet para Kuvendit lidhur me përputhshmërinë e AAC-së, me politikat e aviacionit civil si dhe të gjitha ligjet dhe standardet e zbatueshme në Republikën e Kosovës”*.

Duke u bazuar në Memorandumin shpjegues për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës të datës 23.11.2018, Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit bazuar në nenin 20.3 të Ligjit për Aviacionin Civil ka bërë identifikimin dhe vlerësimin e tre kandidatëve adekuat për këtë post, me ç ‘rast ka bërë propozimin për Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e datës 11.01.2019, e ka emëruar e z. Eset Berisha në postin e Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës.

Pas shqyrtimit të këtij rasti dhe duke i konsideruar të gjitha faktet, provat dhe rrethanat relevante të rastit, të siguruar nga Agjencia kundër Korrupsionit, në pajtim me dispozitat ligjore si dhe duke e marrë parasysh faktin se Autoriteti i Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës funksionon si Agjenci e Pavarur Rregullatore dhe nuk mbikëqyret e as nuk i raporton Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, Agjencia kundër Korrupsionit konstaton se në këtë rast nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin për ekzistimin e konfliktit të interesit dhe

kufizimet e zyrtarit të lartë pas përfundimit të ushtrimit të detyrës publike siç parashihen në nenin 18 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

*Vendimi iu dërgohet:*

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

